Kronikë

Sarandë/ Ktheu banesën në depo armatimi, arrestohet 47-vjeçari në Delvinë! I gjenden kallash, çifte, krehra fishekësh dhe municione (EMRI+VIDEO)

Policia e Vlorës dhe Sarandës njoftuan sot se finalizuan operacionin e koduar “Sunrise”, teksa sekuestroi 1 armë zjarri kallashnikov, 1 armë gjahu çifte, krehra fishekësh dhe municione, që mbaheshin pa leje

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

HOROSKOPI

Redaksia
7 Prill, 13:25 | **Përditesimi: 7 Prill, 13:40**

Share Tweet

Delvinë- Kishte krijuar depo armatimi në banesë, arrestohet 47-vjeçari i dyshuar në Delvinë.

Policia e Vlorës dhe Sarandës njoftuan sot (7 prill) se finalizuan operacionin e koduar “Sunrise”, teksa sekuestroi 1 armë zjarri kallashnikov, 1 armë gjahu çifte, krehra fishekësh dhe municione, që mbaheshin pa leje.

I arrestuari është Laert Tozaj, banues në Delvinë.

LEXO EDHE:
Bledi Çuçi takim me peshkatarët artizanalë: Port i ri për Orikumin, Vlora destinacion turizmi në Mesdhe

> *“Bazuar në informacionet e siguruara nga inteligjenca informative, të cilat bënin me dije se një shtetas posedonte armë në banesën e tij, shërbimet e Komisariatit të Policisë Delvinë organizuan dhe finalizuan me sukses, gjatë paradites së sotme, operacionin policor të koduar “Sunrise”. Si rezultat i këtij operacioni, u arrestua në flagrancë shtetasi L. T., 47 vjeç, banues në Delvinë”, njoftoi policia vendore.*

Armatimi u gjet pas kontrollit të detajuar të banesës së të dyshuarit Tozaj, ku veç dy armëve të zjarrit u zbuluan edhe 2 krehra pistolete dhe një sasi fishekësh.

> *“Materialet procedurale në ngarkim të këtij shtetasi i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për veprime të mëtejshme hetimore dhe procedurale”, sqaroi policia për hetimet që janë ende aktive.*

A.Q/Shqiptarja.com

TAG: armembajtje pa leje | laert tozaj | delvine | sarande | Vlore

Komento

Komente

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Produktet e kontaminuara, si e vlerësoni sigurinë ushqimore në Shqipëri?
6 Prill, 08:55
E mirë | Problem serioz | Nuk e di

Lajme të tjera

'Blof pas blofi doktor', Ardit Bido: U hoqën disa logo nga zyra ime, që do të vendosen diku tjetër, në Vlorë PD nuk merr më shumë se 3 mandate
6 Prill, 17:14

KQZ urdhëron PS të heqë materialet zgjedhore nga zyra në Delvinë! U denoncua nga Ina Zhupa: Shkeli ligjin, zyra pranë KZAZ
6 Prill, 12:11

Fshihte drogën në magazinën e lokalit dhe më pas e shiste në doza, arrestohet 38-vjeçari në Vlorë
6 Prill, 12:01

Vlorë/ Lejoi derdhjen në det të ujërave me përbërje të panjohur, arrestohet inxhinieri teknik
6 Prill, 11:53

Banorët e lumit të Vlorës sërish në protestë, kundër punimeve për ujësjellësin e Himarës: Mos e prekni Shushicën
5 Prill, 17:43

Skandal në Vlorë, tifozët e Flamurtarit futen në fushë dhe godasin trajnerin e Besës
5 Prill, 17:11

Gjiknuri takim me ish-ushtarakë e veteranë në Sarandë: Pension minimal 200 euro, mestari do shkojë 400 euro
5 Prill, 11:04

'Tabacchino' për shitje droge, arrestohen 3 persona në Vlorë
5 Prill, 10:15

Media gjermane 'Petra': Vizitoni Shqipërinë për një eksperiencë autentike dhe të paharrueshme
5 Prill, 09:21

Gjenden tre predha artilerie gjatë punimeve në rrugën Blerimas–Delvinë, rrethohet zona! Pritet ndërhyrja e forcave xheniere

Limos Didani

4 Prill, 14:27

Plagosi me thikë bashkëshorten, lihet në burg 55-vjeçari në Sarandë! Shpreh pendesë: Gjithçka ndodhi pas një debati
4 Prill, 13:04



I mituri me spektrin e autizmit sulm haker 6 institucioneve në Vlorë: E bëra për kuriozitet! Policia: S’ka vjedhje të dhënash! Tentoi edhe faqen e Kuvendit dhe SHISH
4 Prill, 11:37

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje